



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.162/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rustem Thaqi kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Zyhdi Haziri anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Lutfie M. Ajvazi, duke vendosur përkitazi me ankesën e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik AAK-së, me seli në Prishtinë, Dega në Skenderaj, për shkak të vendosjes së flamujve në shtylla të ndriçimit elektrik, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me datë 03.10.2019, mori këtë:

VE N D I M

Refuzohet ankesa Anr.162/2019 e datës 01.10.2019, e paraqitur nga Institutit Demokratik i Kosovës (KDI), me seli në Prishtinë, kundër Subjektit politik AAK, me seli në Prishtinë, Dega në Skenderaj.

A r s y e t i m

Me datën 01.10.2019, Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), ka paraqitur ankesë në PZAP, në të cilën pretendon se me datë 30 Shtator 2019, në rr. "28 Nëntori", në Skenderaj, monitoruesi i tyre ka hasur në flamuj të subjektit politik AAK, të vendosura në shtylla të ndriçimit elektrik.

Me këtë rast paraqitësi i ankesës thekson se ky veprim është në kundërshtim me nenin 33 paragrafi 1 pika b) e LZP-së ligji nr. 03/L-073.

Paraqitësi i ankesës në mbështetje të pretendimeve në ankesë, si dëshmi ka bashkangjitur fotografi të printuar.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e pabazuar

Paneli, vlerëson se pretendimet e paraqitësit të ankesës janë të pabazuara, dhe nuk përbëjnë shkelje të nenit 33 pika b) të LZP-së, pasi flamujt e subjektit politik AAK, janë vendosur në vendin e dedikuar për reklamim - vendosje të flamujve.

Paneli, erdhi në përfundim se janë të paqëndrueshme pretendimet e paraqitësit të ankesës se këto veprime përbëjnë shkelje në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së, dhe me Rregullat Zgjedhore 11/2013 dhe 13/2013, nga ana e subjektit politik AAK, pasi që flamujt

në fjalë, janë vendosur në vendin e dedikuar për vendosjen e flamujve, ashtu siç vërtetohet edhe nga fotografia e bashkangjitur nga palët, të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

Nga arsyet e theksuar më lartë, e duke u bazuar në nenin 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.162/2019 më datën 03.10.2019

Kryesuesi i Panelit
Rrustem Thaqi



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.